



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 16.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 3 dhe 5 korrik 2019.
2. Vijimi i diskutimit nen për nen dhe miratimi në tërësi të projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Kostaq Papa dhe Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama dhe Enada Kapllani.

Grupi i deputetëve propozues:

Eglantina Gjermani dhe Elona Gjebrea.

Të ftuar:

Erzen Tola - drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MASR.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

A jeni gati për ta filluar mbledhjen?

Ariana, a do të njoftohet media?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Para se të fillojmë mbledhjen, që është vazhdim i tematikës së djeshme për miratimin nen për nen të projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, nismë e një grupi deputetësh, si dhe miratimin në tërësi të projektligjit, do të doja t’ia jepja fjalën zotit Ylli, për të thënë me zë të lartë që ne e kemi bërë kuorumin për sot.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë. Ne mund të vazhdojmë normalisht. Ndiej keqardhje për bojkotimin e kryetares, që nuk vjen në këtë projektligj të rëndësishëm.

Milva Ekonomi – Dua të bëj një falënderim të veçantë për punën që ka bërë zoti Beqiraj, që e punoi me shumë vëmendje dhe projektligjin, edhe në bazë të vërejtjeve që bëmë ne nen për nen! Sot kemi një variant edhe më final të projektligjit.

Dua të falënderoj edhe sekretarinë, sidomos zotin Bela dhe zotin Bici, që kanë qenë shumë afër nesh në përfundimin e këtij procesi!

Pa dyshim, Ariana ishte ajo që na mbajti të gjithëve lidhur në orare dhe në tavolinën e rumbullakët të komisionit.

Kështu që secili e ka bërë detyrën e vet për të arritur te kjo mbledhje finale.

Gjithashtu, dua të falënderoj edhe deputetët nismëtarë, që nuk na u ndanë asnjëherë, që nga momenti kur filluam diskutimin e këtij projektligji, sidomos zonja Gjermani, që ka harxhuar më shumë kohë me ne për ta diskutuar!

Nuk e di nëse e keni kopjen e djeshme me vete, por sot janë punuar dy kopje. Është punuar tabela, e cila ka të gjitha pjesët e integruara të diskutimeve që kanë bërë të interesuarit e ndryshëm për këtë projektligj. Ka edhe një kopje në versionin final, që është vetëm projektligji i integruar.

Në projektligjin e integruar na kanë mbetur disa çështje, të cilat kishim nevojë t’i rishikojmë.

Po i lexoj një nga një ato që kanë pasur ndryshime.

Te neni 1 dhe te neni 2 nuk bëmë asnjë ndryshim tjetër, përveçse morëm në konsideratë shënimet që kishin ardhur nga Këshilli i Ministrave, apo jo, zoti Beqiraj?

Te neni 3 patëm diskutime. Ramë dakord për ndryshime dhe i miratuam ato. Ndryshimet ishin kryesisht të terminologjisë juridike.

Ndërruam nenin 4 me nenin 5.

Te neni 4 i ri kemi bërë shumë ndryshime. Kështu që, përveç renditjes së detyrave që ka asambleja e Akademisë, kemi marrë në konsideratë edhe komentet që kanë ardhur nga grupi i interesit.

Mund të na i lexoni një herë ndryshimet e pikave dhe pastaj ato që ramë dakord për t'i hequr?

Zoti Beqiraj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni.

Bujar Çela – Pa i hequr asnjë presje falënderimit që bëre, zonja nënkryetare, doja t'ju sugjeroja diçka. Ne i bëmë të gjitha vërejtjet dhe ju i keni pasqyruar në të gjitha nenet dhe vendet e duhura. Mendoj ta hedhim në votim në tërësi. Ne e kemi kaluar projektligjin nen për nen. Nëse ka ndonjë nen që është shtuar mbrëmë, natën, kjo është histori tjetër.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, shumë zoti Bujar! Na lehtësohet shumë puna, nëse e bëjmë kështu.

Ka disa nene që lidhen me dispozitat kalimtare, që kanë ndryshuar. Është edhe neni i zgjedhjes së kryetarit, që e lamë për riformulim.

Ka edhe një pjesë tjetër të rëndësishme, që lidhet me bashkëpunimin midis Akademisë së Shkencave dhe instituteve të arsimit të lartë, ku ne ndoqëm logjikën e prezantuar këtu nga rektorët, e sjellë këtu edhe si shqetësim i Këshillit të Ministrave, që në rastet kur kërkohej më shumë se kompetenca që kishte ligji i arsimit të lartë nga Akademia, ramë dakord që kjo pjesë të mos ishte në ligj. Prandaj, them të lexohet vetëm neni 3.

Ju lutem, a mund të ma jepni nenin 3?

Ismet Beqiraj – Të lutem, për procedurë!

Milva Ekonomi – Po, më fal!

Ismet Beqiraj – Meqenëse është duke përfunduar reflektimi i të gjitha rregullimeve, shqyrtimeve apo propozimeve që u bënë dje gjatë kalimit nen për nen dhe ne kemi lënë vetëm dy nene për t'u miratuar sot, që kanë të bëjnë me statusin financiar, nenet tranzitore për periudhën tranzitore që do të kalojë, them të mos ndalemi... E mbështes propozimin e zotit Bujar. Më mirë të presim, të kemi edhe draftin final të printuar dhe t'i kalojmë më pas në

parim, siç janë, ku të fokusohemi... Se ne i kemi mbajtur shënimet se ku dhe çfarë është rregulluar, dhe e kemi të qartë këtë pjesë.

Milva Ekonomi – Për nenet që lidhen me pjesën tranzitore, po të hapni nenin 22...

Ismet Beqiraj – Ju lutem, ta fillojmë mbas printimit të saktë, ku janë roli dhe detyrat...!

Milva Ekonomi – Ismet, ta mbaroj një herë nenin 22, se si kemi rënë dakord për të diskutuar dhe se çfarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë, të lutem, Fadil!

...diskutimi është bërë me Kuvendin. Më pas i hedhim diskutimet...

Te neni 22, ku kemi administratën... Tani mund ta merrni fjalën.

Fadil Nasufi – Pajtohem me të gjitha komentet që u bënë në këtë mbledhje sot dhe me gjithë punën e bërë, por unë, zonja kryetare, sugjeroj që nga ana juaj, jo për ne, si komision, por për një informim më të qartë të publikut për gjithçka është hedhur për këtë projektligj, të bëhet edhe një koment se çfarë shtesash, ndryshimesh, pasqyrimi e reflektimi i bëmë ne projektligjit, draftet që paraqitën grupi nismëtar, propozimet shtesë të Këshillit të Ministrave, të rektorëve, zotit Fuga e me radhë, që të jemi shumë të qartë për atë që bëhet lajm sot, që ne kemi bërë një ligj të njëanshëm. Ne kemi bërë një ligj shumë të mirë dhe shumë reflektues.

Prandaj, bëni një koment dhe pastaj të kalojmë te miratimi nen për nen.

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë, zoti Nasufi!

Mendoj që duhet ta ndajmë diskutimin në dy momente.

Së pari, duhet ta ndajmë diskutimin nga pikëpamja procedurale, se çfarë ndoqëm dhe, së dyti, nga risitë legislative që sjell ky projektligj.

Nga pikëpamja procedurale, mendoj që komisioni ynë ishte në lartësinë e duhur të punës, duke zbatuar Kushtetutën dhe Rregulloren një për një, sipas të gjitha detyrimeve që kemi.

Së pari, kjo ishte një nismë deputetësh dhe ata kanë të drejtë të marrin një nismë të tillë ligjore. Kur arritëm këtu, ne bëmë dëgjuesën dhe mbas dëgjësës i shkruam një letër Këshillit të Ministrave, ku i kërkuam të na jepte një opinion, meqenëse ky projektligj mund të ngarkonte me buxhet të shtuar ose të pakësuar Akademinë e Shkencave. Ata u përgjigjën dhe Akademia e Shkencave ka sjellë pranë nesh pikërisht strukturën dhe organikën e Akademisë, duke bërë edhe një cilësim, që ky ligj nuk ndryshon projektbuxhetin.

E keni aty dokumentin që ka sjellë Akademia e Shkencave, që do të jetë pjesë integrale e projektligjit që kemi punuar për ta dorëzuar në Kuvend.

Së dyti, ne ramë dakord të gjithë bashkë për të bërë një kalendar dëgjësash, duke thirrur këtu të gjitha grupet e interesuara, që fillonin nga Akademia e Shkencave, Akademia e Studimeve Albanologjike, rektorët e universiteteve publike dhe grupe akademikësh të pavarur, që kishin platforma alternative. I dëgjuam të gjithë dhe mbajtëm shënime.

Përveç gjërave që kemi mbajtur shënim nëpërmjet veshëve dhe zbardhjes së procesverbaleve të komisionit, u kemi kërkuar atyre që materialet shkrimore t'i depozitonin në sekretari.

Zoti Fuga ka sjellë këtu edhe një projektligj në formën e një broshure, që secili nga ne e ka pasur në dosjen e vet për të punuar.

Ramë dakord që, mbas këtyre dëgjësave, të caktonim një relator. Kemi caktuar si relator zotin Beqiraj, i cili me urdhër të komisionit punoi për një matricë, ku ishin vënë të gjitha shënimet integrale për vëzhgimin në përgjithësi të projektligjit dhe vëzhgimin nën nën. Erdhëm këtu dhe diskutuam nën nën për çdo interes të ndryshëm që kishte nga grupi nismëtarëve.

Çfarë sjell si risi ky projektligj që kemi përpara? Risia e këtij projektligji është që në të gjithë zinxhirin e institutive që merren me kërkim shkencor, Akademia do të zërë një vend të veçantë. Akademia rregullohet duke marrë një status më të lartë, merr një status të pavarur, që varet nga Kuvendi. Kështu, Akademisë i rritet statusi. I japim mundësi asaj të hapë bashkëpunimin me institucione të tjera të ngjashme në rajon, por që janë edhe anëtare të Akademisë Europiane të Kërkimit Shkencor.

U japim mundësi edhe akademikëve të rinj të futen në kërkimin shkencor në një moshë më të hershme.

U japim mundësi edhe grave të kenë një përfaqësim më të mirë në punët e kërkimit dhe të Akademisë së Shkencave në Shqipëri.

Përveç kësaj, ne rregullojmë mënyrën se si zgjidhen kryetari, nënkryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e komisioneve në Akademinë e Shkencave.

Ne sjellim këtu edhe mënyrën se si do të miratohet buxheti i Akademisë së Shkencave në të ardhmen e afërt nga Kuvendi.

Kështu që unë besoj se kemi rregulluar edhe detyrat që ka Akademia, duke marrë në konsideratë që ajo nuk mund t'i ndërvihet veprimtarisë që bëjnë institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri.

Duke parë të gjitha këndvështrimet që kanë ardhur nga grupet e interesit, por edhe duke qenë në linjë me Kushtetutën, ligjet dhe Rregulloren e Kuvendit, unë besoj se sot kemi një produkt final, i cili tregon me shumë qartësi që ky komision ka qenë shumë i angazhuar për të bërë një punë me cilësi.

Nuk e di nëse nismëtarët e këtij projektligji kanë për të shtuar diçka, por unë besoj se të gjitha hallkat e punës, si dhe shënimet nga të gjithë të interesuarit janë marrë në konsideratë nga ky komision.

A duan të shtojnë diçka nismëtarët?

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Në fakt, që në prezantimin që kemi bërë, si grup nismëtar, në asnjë moment nuk kemi thënë se projektligji që kemi depozituar është më i miri i mundshëm. Përkundrazi, kemi thënë që kemi marrë një nismë për ta sjellë në parlament, me qëllimin shumë të mirë që të përfshihet në një debat publik dhe të kemi dëgjesa. Meqenëse ishte projektligj për një institucion të pavarur, menduam që parlamenti, Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik i ka të gjitha hapësirat e duhura dhe tagrin e duhur për ta diskutuar, për të bërë dëgjesa me të gjitha grupet e interesit, pa dyshim, me Akademinë e Shkencave, akademikë, universitete publike dhe të gjithë të interesuarit, që besoj se kanë pasur hapësirën e duhur dhe mundësinë për të dhënë komente, sugjerime, mendime se si të përmirësohet ky projektligj.

Gjithë ky proces ka hapur edhe një debat publik. Besoj se të gjitha mendimet dhe sugjerimet që janë sjellë, janë marrë në konsideratë duke respektuar Kushtetutën, ligjet dhe duke i dhënë projektligjit një formë shumë më të mirë se ajo që kemi sjellë ne, si grup nismëtar. Për këtë ju falënderoj të gjithëve!

Pa dyshim, një falënderim i veçantë shkon për relatorin, që ka bërë një punë të jashtëzakonshme për t'i përfshirë të gjitha komentet dhe sugjerimet, që projektligji t'i shërbejë realisht Akademisë së Shkencave, duke dhënë edhe ne një kontribut modest për reformimin, gjallërimin dhe riaktivizimin e këtij institucioni.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Gjermeni!

Një nga çështjet që na kishte ngelur e pazgjidhur, edhe në diskutimet e djeshme, ishin dispozitat tranzitore, sepse nuk vijmë nga një hapësirë boshe. Ne kemi një Akademi Shkencash, që ka një projektbuxhet. Si do të punohet me këtë Akademi Shkencash, që ka një projektbuxhet, harxhon paratë e buxhetit të shtetit, deri sa të miratohet ligji i ri?

Kështu që, po ta shikoni neni 22 të varianti i vjetër, do t'ju lutesha të shkonit te neni 22, pika 1 mbetet siç është: “Kryesia e Akademisë, në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe për kryerjen e shërbimeve administrative, profesionale, teknike, mbështetet nga administrata e Akademisë.”

Te neni 22, pika 2 riformulohet: “Zgjedhja e kancelarit dhe mënyra e pranimeve në administratë rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për Shërbimin Civil.”

A jeni dakord me këtë riformulim, sipas sugjerimeve që na dha shërbimi juridik i parlamentit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pika 3 e këtij neni bëhet: “Struktura, organika dhe niveli i pagave për administratën, përcaktohen nga asambleja me propozim të kryesisë, e cila ia propozon Kuvendit për miratim.” Besoj se e keni parasysh paragrafin e gjatë të pagave që vjen më pas.

Pika 3 në këtë nen bëhet pika 4 dhe janë të gjitha detyrat që kryen kancelari, që nuk kanë ndryshuar.

Janë të ky varianti i plotë, që po vjen tani.

A jeni dakord me këto ndryshime?

Ndërkohë, neni 26, me titull “Shfuqizime”, bëhet me 2 pika.

Pika e parë është: “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9655, datë 11.12.2006, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, shfuqizohet, me përjashtim të nenit 7 të këtij ligji, “Shpërblimi i anëtarëve””, sepse ka të bëjë me pagat që ata marrin aktualisht.

Pastaj ka një pikë 2, ku thuhet: “Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Akademia e Shkencave i propozon Kuvendit për miratim strukturën, organikën dhe nivelin e pagave për administratën e saj.”

A jeni dakord?

Ne i kemi kapërcyer ato që i kishim merak dje, duke u konsultuar me shërbimin juridik të parlamentit. Këtë çështje e ka ndjekur këshilltari ynë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kemi ne këtu. Kjo është ajo që kemi punuar. Kopja finale do të na vijë tani.

(Anëtarëve të komisionit u shpërndahet një kopje e project ligjit me ndryshimet në formë lineare)

Ka edhe një gjë tjetër, që e kemi ndryshuar. Ramë dakord dhe që zgjedhjen e kryetarit të Akademisë ta vëmë siç e ka statuti. Kështu që është marrë pjesa nga statuti dhe është futur zgjedhja e kryetarit nga statuti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thamë edhe që aty do të shtojmë pikën që zgjedhja e kryetarit shkon në Presidencë dhe e ulëm afatin e presidentit për ta dekretuar, nga 20 ditë në 15 ditë.

A jeni dakord edhe me këto ndryshime? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ju them që janë edhe dy ndryshime që kanë ngelur. Do të marrim edhe nga një kopje finale për ta parë edhe njëherë, nëse keni ndonjë shqetësim tjetër dhe projektligji është i përfunduar me këto ndryshime.

Ju kujtoj që kemi bërë shumë kujdes që të mos ketë asnjë përplasje me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pika e debatuar u hoq fare. Kishte një propozim nga Këshilli i Ministrave, por edhe nga ju. Mbasi e diskutuam edhe me shërbimin juridik, thamë që ligji i procedurës administrative në Republikën e Shqipërisë e lejon këtë gjë. Ndërkohë, mbledhjet e senatit janë të hapura për të gjithë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Kolegë, mbas kësaj mbledhjeje, komisioni duhet të bëjë raportin për të gjithë veprimtarinë që zhvilluam për projektligjin.

Ndërkohë, është përgatitur drafti i raportit, që e ka bërë zoti Bela, por unë dhe zoti Beqiraj kemi bërë disa komente shtesë. Kështu që, edhe ai raport është i finalizuar dhe është përshkruar në mënyrë narrative se çfarë ka ndodhur në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sa të mbarojë edhe procesi i miratimit në tërësi, që ta vendosim aty.

Të kemi mbajtur me hatër, Bujar.

(Mungesë regjistrimi.)

E keni marrë të gjithë nga një kopje. Është kopja që kemi miratuar dhe. Hidhni një sy, në qoftë se keni për të bërë diskutime të tjera. Ka një dy-tri gabime ortografike, që i kapa unë. Mungojnë ë-të dhe ç-të, që mbase rregullohen në proces.

Ndërkohë, a jeni dakord për të kaluar në votimin në tërësi të këtij projektligji?

Fidel, Musa, a jeni dakord për ta votuar në tërësi projektligjin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, Erzen.

Erzen Tola – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Dua të bëj vetëm një sugjerim, edhe për t'ju ndihmuar. Te neni 22, siç e thatë edhe ju, është përcaktuar që zgjedhja e kancelarit dhe mënyra e pranimeve në administratë të rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për Shërbimin Civil.

Së pari, mendoj se kancelari duhet të barasvlerësohet me një nga pozicionet në Shërbimin Civil, pra, sipas së cilës përzgjedhje apo zgjedhje do të bëhet kancelari, sepse në nivel drejtorie, për shembull, drejtor drejtorie, përzgjedhja është e ndryshme në raport me sekretarin e Përgjithshëm apo drejtorin e Përgjithshëm.

Për të qenë sa më i zbatueshëm ligji, mendoj se duhet barasvlerësuar me një nga pozicionet e parashikuara nga Shërbimi Civil.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, të barasvlerësohet ky profesion, duke qenë se nuk parashikohet kancelari në Shërbimin Civil.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Mungesë regjistrimi.)

Milva Ekonomi – Atëherë, do ta miratojmë në tërësi këtë projektligj?

Kush është dakord? Kush nuk është dakord?

Ta miratojmë në tërësi dhe t'i japim detyrë sekretarisë të shikojë gabimet ortografike dhe renditjen numërore të numrave, se mund të jetë 8, 10...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, 1,2,3,4,6... Mungon numri 5. Kur të bëhet zbardhja e plotë, do t'i rregullojmë të gjitha numërimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Do të rregullohen gabimet, se ka gabime ortografike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj -...te neni 4 është lënë përgjysmë.

Milva Ekonomi – “Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe në funksionet zyrtare...”

Ismet Beqiraj – 17-tën e keni lënë deri këtu: “Të garantojë zgjedhjen e anëtarëve të asamblesë...”!

Nuk është formuluar mirë pika 17 ose nuk është pasqyruar saktë aty. Edhe pika 18, edhe pika 19, nuk janë formuluar mirë. Të tria këto pika nuk janë formuluar mirë.

Milva Ekonomi – Pika 17 ka të bëjë me barazinë gjinore: “Të garantojë që zgjedhja e anëtarëve të asamblesë të zhvillohet në përputhje me parimin e barazisë gjinore, duke synuar progresivisht balancën gjinore të përfaqësimit.” Mungon një “të” dhe një “që”, të cilat do të vendosen: “Të garantojë që zgjedhjet e anëtarëve të asamblesë të zhvillohen në përputhje me parimin e barazisë gjinore, duke synuar progresivisht balancën gjinore të përfaqësimit.”

Ismet Beqiraj – Dakord.

Po pika 18?

Milva Ekonomi - Te pika 18, pjesa e parë është kjo. Pjesa e dytë është ajo që ka ngelur te ligji: “Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe në funksionet zyrtare.”

Ismet Beqiraj – Kaq?

Milva Ekonomi – Jo, vazhdon.

Ismet Beqiraj – Po ku është, pra?

Milva Ekonomi – E ke tek varianti i djeshëm dhe do të merret dhe do të vendoset këtu.

Ismet Beqiraj – Unë këtë po kërkoj.

Milva Ekonomi – Çfarë pike ka qenë më parë?

(Diskutime pa mikrofon.)

Edhe në funksione zyrtare. Ja, po e lexojmë tani se si bëhet.

Ismet Beqiraj – “...e njësuar të gjuhës shqipe në funksionet zyrtare dhe...”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

“Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për integrimin në gjuhën shqipe të terminologjive bashkëkohore të shkencës dhe teknikës, si dhe për konsolidimin e gjuhës shqipe në të gjitha fushat e shkencës.”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

U ndryshua? Dakord. “Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika...”, çfarë është ndryshuar?

Milva Ekonomi – “Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe zyrtare, të terminologjive bashkëkohore të shkencës dhe teknikës, si dhe për konsolidimin e gjuhës shqipe në të gjitha fushat e shkencës.” Ky është formulimi, por ka ikur nga tabela.

Ismet Beqiraj – Si është?

Milva Ekonomi - Në këtë variant është: “Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe zyrtare, të terminologjive bashkëkohore të shkencës

dhe teknikës, si dhe për konsolidimin e gjuhës shqipe në të gjitha fushat e shkencës.” Ky është formulimi final.

Ismet Beqiraj – Atëherë, kush na e ka bërë këtë...?

Milva Ekonomi – E ka bërë kompjuteri pa dashje. Do ta kontrollojmë. Ky është varianti final.

Ismet Beqiraj – Atëherë, do të korrigohet.

Milva Ekonomi – Do ta vendosim kështu.

Ismet Beqiraj – Po për pikën 19, të lutem?

Milva Ekonomi – Pika 19 është propozimi që vjen nga grupi nismëtar dhe është kështu.

Ismet Beqiraj - Po, sigurisht.

Me gjithë këto ndryshime ia vlen të bëhet një lexim edhe për publikun, që ta dijë që ka të bëjë me Akademinë, se kush është sipas projektligjit të ri...

Milva Ekonomi – E thamë atë. Unë bëra një ndërhyrje, Tina më mbështeti propozimin. Edhe ju bëtë një ndërhyrje... I kemi të tëra. E vetmja gjë që duhet të bëjmë tani është që unë dhe ti, bashkë me sekretarinë, të ulemi dhe të shikojmë nëse nga kopjimi prej tabele, në kopjimin linear që ka projektligji, ka ndodhur apo jo ndonjë ndryshim si ky që kapëm tani dhe të vëmë numërimet e drejta, kronologjike të neneve.

Unë mendoj se e meritojmë një falënderim nga të dyja anët e tryezës. Ta falënderojmë njëri-tjetrin dhe ta quajmë mbledhjen të mbyllur për sot, me detyrën që Ismeti dhe Milva të vazhdojnë të punojnë me Muhametin për të mbaruar raportin. Ndërkohë, të marrim edhe dy sy të freskët, për shembull, sytë e Gazit dhe të Arianës, dhe të shikojnë nëse varianti tabular, dhe varianti linear, janë njësoj të gjithë projektligjin. Të gjitha ndryshimet janë hedhur tani në variantin linear. Dhe ky kalim u bë për lehtësi pune.

Dakord? U pastrua.

Variantin që do të jetë edhe daktilografisht i zbardhur, t’i kërkojmë Arianës t’ua shpërndajë të gjithë kolegëve tanë të komisionit, edhe kryetares, që sot nuk deshi të ulej në këtë vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sapo e thashë.

Këtë dokument që keni përpara, konsiderojeni si dokument pune, deri sa të merrni variantin final të dokumentit.

A jeni dakord?

E falënderojmë edhe Erzen Tolën, që e kishim këtu gjatë gjithë kohës!

Faleminderit shumë!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA